



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

**VENDIM**

**Nr. 3, datë 01.03.2019**

**PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË APLIKIMIT NË POZICIONIN VAKANT PËR  
INSPEKTOR I LARTË I DREJTËSISË**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 147/d të Kushtetutës dhe të shkronjës “a” të pikës 2 të nenit 201 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

**VENDOSI:**

1. Hapjen e procedurës së aplikimit në pozicionin vakant për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

**KRYETARI**

**Ardian Dvorani**